



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM  
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU  
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



# RAPORTI VJETOR

# 2013

---

Prishtinë  
mars 2014



## Vizioni

*“Shërbime cilësore, dhe të qëndrueshme të ujësjellësit, kanalizimit për të gjithë qytetarët e Kosovës.”*

## Misioni

*“Të bëjë Rregullimin e kompanive të ujësjellësit, kanalizimit në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikën e mira Evropiane, veçanërisht duke u fokusuar në promovimin e efikasitetit, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve, me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.”*

# Përmbajtja

<b>PËRMBAJTJA</b> .....	<b>3</b>
<b>AKRONIMET DHE SHKURTESAT</b> .....	<b>5</b>
<b>1. PARATHËNIE</b> .....	<b>6</b>
<b>2. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK</b> .....	<b>8</b>
2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK .....	8
2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUK.....	9
<b>3. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUK</b> .....	<b>10</b>
3.1. LICENCIMI .....	10
3.2. MONITORIMI I OFRUESIEVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT .....	12
3.2.1. MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE (OBJEKTIVAVE).....	13
3.2.1.1. PËRMBUSHJA E CAQEVE PËR SHPENZIMET OPERATIVE PËR UJË DHE UJËRA TË ZEZA .....	13
3.2.1.2. PËRMBUSHJA E CAQEVE TË FATURIMIT .....	14
3.2.1.3. PËRMBUSHJA E CAQEVE TË ARKËTIMIT .....	14
3.2.2. PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE KANALIZIMIT PËR VITIN 2014 .....	15
3.2.3. MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SEKTORIT DHE OFRUESËVE TË SHËRBIMIT .....	16
3.2.3.1. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT .....	17
3.2.3.2. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT NË NIVEL TË KOMPANIVE .....	17
3.2.3.3. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME TË KANALIZIMIT NË NIVEL TË KOMPANIVE .....	18
3.2.3.4. UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UJI I PA-FATURUAR NË NIVEL TË SEKTORIT.....	18
3.2.3.5. EFIÇENCA E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT.....	19
3.2.3.6. SHKALLA E ARKËTIMIT .....	19
3.2.3.7. UJI I PAFATURUAR .....	20
3.2.3.8. KUALITETI I UJIT .....	21
3.2.3.9. PROPORCIONI I KONSUMATORËVE ME UJËMATËS .....	22
3.2.3.10. PERFORMANCA E NHE 'IBER LEPENCI' .....	23
3.3. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE .....	23
3.3.1. ZBATIMI I STANDARDEVE TË SHËRBIMIT.....	23
3.3.1.1. FATURIMI NË NDËRTESAT KOLEKTIVE .....	24
3.3.1.2. VAZHDIMI I ZBATIMIT TË VENDIMIT PËR PAUSHALL.....	25
3.3.1.3. FATURAT .....	26
3.3.1.4. REGJIMI I KUFIZUAR I SHËRBIMEVE TË UJIT.....	26
3.3.2. ROLI DHE AKTIVITETET E KOMISIONEVE KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE( KKK) .....	26
3.3.2.1. AKTIVITETET E KKK .....	27
3.3.2.2 SHQYRTIMI I ANKESAVE .....	27
<b>4. AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL</b> .....	<b>29</b>
4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV .....	29
4.1.1. AMANDAMENTIMI I LIGJIT NR.03/ L-086 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2004/49 MBI VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË UJËSJELLËSIT, KANALIZIMIT DHE MBETURINAVE ("LIGJI NR. 03/L-086").....	29
4.1.2. SHQYRTIMI I RREGULLËS PËR STANDARDET MINIMALE TË SHËRBIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË UJIT NË KOSOVË("R03/U&K").....	29
4.1.3. AMANDAMENTIMI I LICENCAVE TË SHËRBIMIT .....	29
4.1.4. PLOTËSIMI I KUSHTEVE TË LICENCËS SË SHËRBIMIT .....	29

---

4.1.5. PARALAJMËRIMET .....	30
4.1.6. PROCEDURAT GJYQËSORE .....	31
4.1.7. SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR SHKYÇJE KOLEKTIVE.....	31
<b>5. RELACIONET E JASHTME.....</b>	<b>32</b>
5.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA .....	32
5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË .....	33
5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN .....	33
<b>6. ASPEKTET FINANCIARE.....</b>	<b>35</b>
6.1. SHPENZIMET .....	35
6.2. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2013 .....	36
6.3. ASETET E ZRRUK.....	36
<b>7. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>37</b>

**AKRONIMET DHE SHKURTESAT**

1. ZRRUK – Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
2. KBPMPH – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor
3. MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
4. MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
5. MIE – Ministria e Integriteteve Evropiane
6. IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
7. NJPM – Njësia për Politika e Monitorim
8. TFU – Task Forca e Ujit
9. KRU – Kompania rajonale e Ujësjellësit
10. Nj.O. – Njësia Operative
11. KKK – Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
12. TKP – treguesit Kyç të Performancës
13. KK – Kuvendi Komunal
14. AKMM – Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
15. ESK – Enti i Statistikave të Kosovës
16. ERRU – Enti Rregullator i Ujit (Shqipëri)
17. SHUKOS – Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës
18. SHUKALB – Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve Shqipëri
19. IBNET – International Benchmarking Network ( Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarkingut)
20. DWP – Danube Water Program (Programi i Ujërave të Danubit)
21. BB – Banka Botërore
22. BWA – Bulgarian Water Association (Shoqata e Ujërave të Bullgarisë)
23. PVPE – Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian
24. DSPA – Dialogu i Stabilizim Asocimit
25. NHE – Ndërmarrje Hidro Ekonomike
26. NPK – Ndërmarrja Publike Komunale

# 1. Parathënie

Të nderuar,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush raportin Vjetor – 2013 (të gjashtin me radhë) të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) për informim, shqyrtim e miratim.

Në këtë Raport përveç aktiviteteve dhe arritjeve të Institucionit tonë në përmbushje të obligimeve që i përcakton Ligji, është analizuar dhe paraqitur edhe gjendja aktuale e sektorit të Ujit në Republikën e Kosovës.

Monitorimi i Kompanive të licencuara në aspektin e zbatimit të Ligjit dhe të Rregullave në fuqi, me qëllim të ngritjes së nivelit të cilësisë të shërbimeve të ofruara për konsumatorët si çdo vit edhe për vitin 2013 ka qenë objektiv i punës së ZRRUK. Duke pasur parasysh se ofruesit e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit në Kosovë kanë monopol, ky proces është i rëndësishëm në radhë të parë për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve, për të siguruar transparencën e punës së tyre, si dhe për të stimuluar konkurrencën mes kompanive me qëllim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve.

Monitorimi i Ofruesve të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit bëhet në dy aspekte: (i) në aspektin e përmbushjes së caqeve (objektivave) të aprovuara nga ZRRUK përmes procesit tarifor dhe (ii) në aspektin e performancës së Kompanive.

Mospërmbushja e caqeve (objektivave) të përcaktuara për vitin 2013 nga shumica e kompanive ka qenë faktor determinues për përcaktimin tarifave për vitin 2014 gjatë procesit të rishikimit të tarifave. Si rrjedhojë tarifat volumetrike të shërbimeve të furnizimit me ujë për pesë (5) kompani regjionale të shërbimeve të ujit për vitin 2014 kanë mbete të njëjta me tarifat e vitit 2013, ndërsa për 0.01 €/m<sup>3</sup> janë ngritë tarifat e shërbimit të ujit për konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak në zonat e shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor” sh. a. Prizren dhe KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë. Gjatë rishikimit të tarifave për vitin 2014 gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar krijimit të parakushteve për qëndrueshmëri financiare të KRU-ve dhe mundësinë e pagesës së faturave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Në përputhje me “Planin Strategjik 2012 – 2014” të ZRRUK, gjatë vitit 2013 i kemi kushtuar vëmendje të posaçme përmbushjes së Standardeve Minimale të Shërbimit. Përmbushja e këtyre standardeve nga ana e KRU-ve përveç që është obligative, njëkohësisht është edhe mjeti më efikas i cili siguron promovimin e interesave të konsumatorëve.

Në këtë aspekt edhe gjatë vitit 2013 ZRRUK është angazhuar që KRU-të të zbatojnë një faturim sa më të saktë, me fokus të veçantë faturimin në ndërtesat e banimit kolektiv të cilat faturohen sipas leximit të ujëmatësit të përbashkët. Për këtë qëllim janë bë inspektime dhe pas identifikimit të disa parregullsive, sipas rekomandimeve të ZRRUK, ka filluar kompensimi i konsumatorëve të dëmtuar (vlen të ceket se në periudhën Qershor – Dhjetor, vetëm në dy lagje të Prishtinës janë kompensuar rreth 770 konsumatorë të dëmtuar). Ky proces nën monitorimin e ZRRUK është duke vazhduar edhe gjatë vitit 2014 deri në korrigjimin e të gjitha rasteve.

Edhe gjatë vitit 2013, ZRRUK ka vazhduar të imponojë ndikimin dhe qëndrimin e vet të KRU-të dhe të konsumatorët që uji i cili shpenzohet nga konsumatorët të matet me ujëmatës, në mënyrë që faturimi të jetë sipas konsumit. Duke vërejtur se Vendimi për faturim paushall sipas procedurave Interne të aprovuara nga ZRRUK ka pasur rezultate pozitive në aspekt të vendosjes së ujëmatësve, ZRRUK ka vendosur shtyrjen e afatit të aplikimit të këtij Vendimi edhe gjatë vitit 2014.

Pas angazhimeve të shumta të ZRRUK dhe të gjitha palëve tjera, nga data 31 Tetor 2013, Komuna e Deçanit është integruar në kuadër të zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” – Pejë.

Për të shtatin vit me radhë ZRRUK vlerëson ecurinë e sektorit dhe shpall performancën e Kompanive të Licencuara (duke theksuar ecuritë pozitive dhe ngecjet) përmes Raportit të Performancës. Raporti është dokument publik, informacionet dhe analizat e të cilit mund ti ndihmojnë Kompanitë , politikëbërësit e sektorit por edhe vet konsumatorët për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes së sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Nga viti 2013 performanca e ofruesve të shërbimeve të Kosovës është pjesë e bankës së shënimeve të IBNET (Rrjetit ndërkombëtar të benchmarkingut për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit).

Gjatë vitit 2013 për arsye të operimit pa Licencë, u është shqiptuar gjobë në vlerë prej nga 20.000 € 3 (tri) kompanive: NPK "Lypoteni" – Kacanik", NPK "Štrpce" – Shtërpce dhe NPK "Vodovod Ibar"-Mitrovica e Veriut.

Shpresoj se informacionet dhe rekomandimet e këtij Raporti do të jenë të dobishme për të gjitha palët e interesit të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e politikave në sektorin e ujit në Kosovë.

Dëshiroj gjithashtu t'ju siguroj se sikurse gjatë vitit 2013 edhe në të ardhmen, ZRRUK me të njëjtin përkushtim do të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit, transparencës, bashkëpunimit ndërinstytucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që me autoritetin e tij rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur mes ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.



**Raif Preteni**  
Drejtore i ZRRUK,

## 2. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUK

### 2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) është organ i pavarur rregullator, i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Kosovë, i themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49](#), në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, duke transferuar raportimin e ZRRUK, nga UNMIK-u tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUK është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe furnizuesve të ujit me shumicë.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUK janë:

**Licencimi** i ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë ;

**Përcaktimi i tarifave** që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;

**Mbrojtja e interesave të konsumatorëve**, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe shërbimet e ofruara të jenë në pajtim me standardet adekuate të përcaktuara;

**Monitorimi dhe raportimi i performancës** së ofruesve të shërbimeve;

**Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shqyçje** individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;

**Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve** dhe mbështetja e punës së tyre.

Pra, ZRRUK është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit në Kosovë, iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikente dhe cilësore me çmim të përballueshëm.

Në përmbushjen e përgjegjësisë së veta rregullatore, ZRRUK bazohet në kornizën ligjore që është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086, si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekondar (8 Rregullave) të nxjerra nga ZRRUK në Janar të vitit 2005 dhe të Amandamentuara kohë pas kohe, *edhe gjatë vitit 2013*.



## 2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUK

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUK udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori, si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës, si dhe për marrjen e vendimeve Rregullatore, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat 5 vjeçar.

Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUK ka aprovuar strukturën organizative të organizimit, sipas të cilës departamentet e ZRRUK i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUK-it.

ZRRUK përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet Rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: **Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore**, **Departamenti i Performancës dhe Departamenti për Ligj dhe Licenca**, ndërkaq përgjegjës për mbështetjen e veprimtarisë rregullatore të ZRRUK-it është **Departamenti për Administratë dhe Financa**.

Struktura organizative e ZRRUK në formë skematike është dhënë në vijim:



## 3. Aktivitetet Rregulatore të ZRRUK

### 3.1. LICENCIMI

Në vijim po ju paraqesim Kompanitë Licencuara nga ZRRUK të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, kanalizimit dhe furnizimit të ujit me shumicë të cilat veprojnë në Kosovë.

Ripërtirja e Licencave për këto Kompani është bërë nga ZRRUK me datën 01.11.2012 në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086 si dhe me procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh. Aktualisht të gjitha kompanitë në vijim janë të licencuara deri me 31.10.2015

#### (i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

1. **KRU "Prishtina" Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Graçanicë, Shtime dhe Drenas;
2. **KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamushë;
3. **KRU "Hidrodrini" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan
4. **KRU "Mitrovica" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRU "Radoniqi" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren;
6. **KRU "Hidromorava" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
7. **KRU "Bifurkacioni" Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunën: Ferizaj .

*Shënimi: KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica" janë të licencuara edhe për furnizim të ujit të përpunuar me shumicë.*

Licencat e shërbimit janë lëshuar me Kushte Plotësuese të cilat janë:

- i. Sigurimi i lejeve për nxjerrje të ujit dhe shkarkim të ujërave të zeza,
- ii. Lidhja e Marrëveshjeve të Shërbimit me Komunat, të cilat nuk e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje,
- iii. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare.

Këto kushte kanë mbështetje në legjislacionin aktual primar dhe sekondar.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit për shkak të refuzimit, dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUK.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-086, dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/18, të datës 08.06.2011, edhe gjatë vitit 2013 ZRRUK ka vazhduar të angazhohet së bashku me të gjitha palët tjera për kthimin në menaxhimin e KRU "Bifurkacioni" të Njësisë Operative të Kaçanikut dhe kthimin e Njësisë Operative të Deçanit në kuadër të KRU "Hidrodrini"

Për mosposedim të Licencës së shërbimit (siç është paraparë me kuadrin aktual të legjislacionit primar dhe sekondar), ZRRUK gjatë vitit 2013 ka proceduar Paralajmërimi për: NPK "Vodovod

Ibar"-Mitrovica e Veriut ,NPK "Lypoteni"-Kaçanik dhe NPK "Sterpce"-Shtërpce.

***Për të tri rastet, duke respektuar procedurën e mëtejme ZRRUK ka nxjerr Vendim për gjobitje për këto 3 Kompani - për secilën Kompani nga 20.000 €.***

## (ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit të Papërpunuar me Shumicë

Furnizimi i ujit të papërpunuar me shumicë me Rregulloren 2004/49 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë të papërpunuar me shumicë është:

1. **"Ibër-Lepenci" Sh.A.** e cila furnizon ujë të papërpunuar me shumicë për KRU "Mitrovica" Sh.A. dhe KRU "Prishtina" Sh.A.

Ripërtirja e Licencës së kompanisë "Ibër-Lepenci" është bërë me datën 31.10. 2012 dhe vlen deri më datën 31.10. 2015.

*Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit*



KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KRU-të
Prishtina Podujeva Fushë Kosova Obiliçi Lipjani Drenasi Shtime Graçanica	Prizreni Suhareka Malisheva Dragashi Mamusha	Peja Istogu Klina Juniku Deçani	Mitrovica Skenderaj Vushtria	Gjakova Rahoveci	Ferizaji	Gjilani Kamenica Vitia	Novoberda Zubin Potoku Leposaviçi Shtërpca Kaçaniku Zveçani

### 3.2. MONITORIMI I OFRUESIEVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

Për t'i pasur më të qarta aktivitetet, hapat, masat dhe veprimet e Institucionit tonë, si dhe për të dhënë lexuesit të këtij Raporti një pasqyrim të përgjithshëm të gjendjes së sektorit të ujit në Kosovë, në vijim janë paraqitur arsyet, llojet dhe procedurat e monitorimit të cilat janë aktivitetet i përhershëm i ZRRUK.

- **Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave)** – me anë të këtij procesi monitorohet përmbushja e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ZRRUK përmes procesit tarifor.

Përmbushja apo mospërmbushja e këtyre caqeve është një ndër faktorët determinues për përcaktimin e tarifave të vitit pasues .

Procedurat e monitorimit kryhen nga analizimi i të dhënave për përmbushje apo mospërmbushje të caqeve të aprovuara të disa prej treguesve kryesor – tregues të cilët janë të njëjtë për analizimin e të gjitha kompanive.

Të dhënat sigurohen nga raportimet në baza mujore dhe raportet vjetore të KRU-ve, të cilat si plotësisht të vlefshme llogariten pasi të ketë përfunduar procesi i analizimit dhe auditimit nga stafi profesional i ZRRUK

- **Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit dhe kanalizimit (kompanive)** – Me anë të këtij procesi monitorohet performanca e kompanive për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë të tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet.

Arritjet maten në bazë të Treguesve Kyç të Performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin.

Performanca matet kundrejt mesatares së sektorit si dhe performancës vetanake në vitin 2013 në raport me vitin 2012

Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat kompanitë i paraqesin në ZRRUK në baza mujore dhe Raportimin vjetor, në pajtim me obligimet raportuese që kompanitë kanë ndaj ZRRUK.

Bazuar në këto të dhëna, pas analizave si dhe verifikimit të tyre përmes procesit të auditimit, si çdo vit edhe në vitin 2013 ZRRUK ka publikuar Raportin Vjetor të Performancës (për vitin 2012) në të cilin pasqyrohet performanca e sektorit në përgjithësi dhe e Kompanive veç e veç.

***Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përmbushjes së caqeve dhe analizën e performancës për vitin 2013 janë të dhëna të pa audituara (meqenëse pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur) ndërsa të dhënat e vitit 2012 janë të verifikuara me procesin e auditimit të vitit 2012. Të dhënat e vitit 2013 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.***

### 3.2.1. MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE (OBJEKTIVAVE)

Duke pasur parasysh faktin se viti 2013 ka qenë viti i dytë (2) i tarifave rregullatore të procesit të përmblytur tre (3) vjeçar tarifor të viteve 2012-2014, ndër aktivitetet tona kryesore ka qenë implementimi dhe realizimi i planifikimeve të vitit 2013, si dhe rishikimi dhe përcaktim të tarifave të shërbimit publik të ujit për vitin e fundit të periudhës tre (3) vjeçare të tarifave të vitit 2014.

Rëndësi të veçantë gjatë vitit për të cilin po raportojmë i kemi kushtuar dhe do të vazhdojmë t'i kushtojmë edhe në të ardhmen monitorimit të të dhënave të përcaktuara si cak gjatë procesit tarifor dhe vlerësimeve për shkallën e përmbushjes/mos përmbushjes së objektivave të përcaktuara për çdo kompani veç e veç dhe sektorit në përgjithësi.

Nga monitorimi i të dhënave të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2013, mund të konstatojmë se kompanitë në masën më të madhe kanë dështuar t'i përmbushin caqet e përcaktuara me procesin rregullator për treguesit kryesorë të shikuar.

Në vijim përmes tabelave dhe shpjegimeve është paraqitur shkalla e përmbushjes së caqeve të aprovuara nga ZRRUK të disa prej treguesve kryesor në nivel të sektorit nga kompanitë e licencuara të shërbimeve të ujit gjatë vitit 2013.

Ndër treguesit kyç të cilët përcaktojnë dhe japin një pasqyrë më të qartë financiare janë shpenzimet operative, faturimi dhe arkëtimi.

Të dhënat e aprovuara të tabelave të më poshtme janë indeksuar me Indeksin e Çmimeve të Konsumit të Kosovës, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 06/2011 – 11/2013 (Mesataren e njëmbëdhjet muajve të vitit 2013).

Vlerat e paraqitura për të dhënat në Tabelat Nr. 2, 3 dhe 4 nuk përmbajnë të dhënat financiare të shërbimeve të ujit të cilin e ofron KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për pjesën veriore të qytetit.

Në vijim janë paraqitur të dhënat për këta tregues dhe shkalla (përqindja) e përmbushjes/mos-përmbushjes së caqeve të këtyre treguesve.

#### 3.2.1.1. Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative të aprovuara nga ZRRUK, për ujë dhe ujëra të zeza dhe ato të realizuar nga kompanitë e shërbimeve të ujit në nivel të sektorit, me % e realizimit të caktuar për vitin 2013.

Tabela Nr. 1. Të dhënat e shpenzimeve operative të aprovuara dhe realizuara gjatë 2013

Të dhënat sektoriale	Kategoria e shpenzimeve operative	Njësia monetare	Shuma e aprovuara nga ZRRUK 2013	Shuma e realizuara nga KRU 2013	%
	Shërbimi i ujit	€	14,688,276	18,151,676	123.58%
	Shërbimet e ujërave të zeza	€	821,983	1,188,732	144.62%
<b>Totali i shpenzimeve sektorial</b>		€	<b>15,510,259</b>	<b>19,340,408</b>	<b>124.69%</b>

Siç shihet edhe nga tabela Nr.1, në nivel sektori janë tejkaluar shpenzimet e aprovuara. Shprehur në përqindje ky tejkalim i kostove operative ka arrit të jetë 24,69%, dhe si të tilla vlerësohen negativisht.

### 3.2.1.2. Përbushja e caqeve të faturimit

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat sektoriale të faturimit të aprovuar nga ZRRUK për ujë dhe ujëra të zeza, të dhënat për faturimin e realizuar nga kompanitë për ujë dhe ujëra të zeza dhe % e realizimit të caktuar për vitin 2013

Tabela Nr. 2. Të dhënat e shumave të aprovuara faturim dhe realizuar gjatë 2013

Të dhënat sektoriale	Te dhënat e faturimit	Njësia monetare	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuara nga KRU 2013	%
	Shërbimi i ujit	€	31,426,396	26,142,172	83.19%
	Shërbimet e ujërave të zeza	€	4,160,360	3,091,224	74.30%
<b>Totali i faturimit sektorial</b>		€	<b>35,586,756</b>	<b>29,233,396</b>	<b>82.15%</b>

Siç shihet edhe nga Tabela Nr. 2., caqet e aprovuara nga procesi rregullator për vitin 2013 nuk janë përbushur. Në nivel sektori mospërbushja e caqeve të faturimit në total e shprehur në përqindje është 17,85%.

### 3.2.1.3. Përbushja e caqeve të arkëtimit

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat sektoriale të arkëtimit të aprovuar nga ZRRUK për ujë dhe ujëra të zeza, të dhënat për arkëtimin e realizuar nga kompanitë për ujë dhe ujëra të zeza dhe % e realizimit të caktuar për vitin 2013

Tabela Nr. 3. Të dhënat e shumave të aprovuara për arkëtim dhe realizim gjatë 2013

Të dhënat sektoriale	Te dhënat e arkëtimit	Njësia monetare	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuara nga KRU 2013	%
	Shërbimi i ujit	€/vit	23,428,225	18,420,851	78.63%
	Shërbimet e ujërave të zeza	€/vit	3,148.874	2,104,753	66.84%
<b>Totali i arkëtimit sektorial</b>		€/vit	<b>26.577.099</b>	<b>20,525,604</b>	<b>77.23%</b>

Siç shihet edhe nga Tabela Nr. 3., caqet e aprovuara nga procesi rregullator për vitin 2013 nuk janë përbushur. Në nivel sektori mospërbushja e caqeve të arkëtimit në total e shprehur në përqindje është 22,27%.

**3.2.2. PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE KANALIZIMIT PËR VITIN 2014**

Rishikimin e tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e kanalizimit të kompanive sipas zonave të tyre të shërbimeve për vitin 2014, ka qenë një ndër angazhimet tona edhe gjatë vitit 2013.

ZRRUK ka përcaktuar tarifat e vitit 2014 nga periudha afatmesme e procesit rregullator të tarifave të viteve 2012-2014 për shtatë (7) kompanitë regjionale të licencuara që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe dy tarifa të ujit të pa trajtuar me shumicë nga NH "Iber-Lepenc" sh. a. Prishtinë për furnizim të Komunës së Drenasit me ujë, e cila është në kuadër të KRU "Prishtina" sh.a Prishtinë, dhe tjetrën për furnizim të KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë. Baza e rishikimit të tarifave për faturim të konsumatorëve për vitin 2014 ka qenë marrja në konsideratë të lëvizjeve inflatore gjatë periudhës tetor/2011 – nëntor/2013 dhe shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave për vitin 2013 si të treguesve të pasqyruar me lart ashtu edhe të treguesve tjerë.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur tarifat e shërbimit të ujit të aplikuara gjatë vitit 2013 dhe ato të përcaktuara për vitin 2014.

Tabela Nr. 4. Pasqyra e tarifave të shërbimit të ujit të aplikuara gjatë vitit 2013 dhe ato të përcaktuara për vitin 2014

Selit e kompanive regjionale	Kategoritë e konsumatorëve	Viti 2013				Viti 2014			
		Tarifa Fikse mujore €/muaj	Tarifa volum. për ujë €/m3	Tarifa volu. për kanalizim €/m3	Tarifa volumet. komulat. €/m3	Tarifa Fikse mujore €/muaj	Tarifa volumet. për ujë €/m3	Tarifa volu. për kanalizim €/m3	Tarifa volumet. komulat. €/m3
Prishtina	Shtëpiak	1.00	0.38	0.05	0.43	1.00	0.38	0.05	0.43
	Jo-shtëpiak	3.00	0.87	0.11	0.98	3.00	0.87	0.11	0.98
Prizreni	Shtëpiak	1.00	0.35	0.05	0.40	1.00	0.36	0.05	0.41
	Jo-shtëpiak	3.00	0.69	0.09	0.78	3.00	0.70	0.09	0.79
Peja	Shtëpiak	1.00	0.23	0.06	0.29	1.00	0.23	0.06	0.29
	Jo-shtëpiak	3.00	0.47	0.13	0.60	3.00	0.47	0.13	0.60
Mitrovica	Shtëpiak	1.00	0.35	0.10	0.45	1.00	0.35	0.10	0.45
	Jo-shtëpiak	3.00	0.70	0.26	0.96	3.00	0.70	0.26	0.96
Gjakova	Shtëpiak	1.00	0.35	0.08	0.43	1.00	0.36	0.08	0.44
	Jo-shtëpiak	3.00	0.70	0.21	0.91	3.00	0.70	0.22	0.92
Ferizaj	Shtëpiak	1.00	0.32	0.13	0.45	1.00	0.32	0.13	0.45
	Jo-shtëpiak	3.00	0.64	0.33	0.97	3.00	0.64	0.33	0.97
Gjilani	Shtëpiak	1.00	0.33	0.08	0.41	1.00	0.33	0.08	0.41
	Jo-shtëpiak	3.00	0.65	0.20	0.85	3.00	0.65	0.20	0.85
Mesatarja e sektorit	Shtëpiak	1.00	0.33	0.08	0.41	1.00	0.33	0.08	0.41
	Jo-shtëpiak	3.00	0.67	0.19	0.86	3.00	0.68	0.19	0.87

Tarifat e përcaktuara për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë vitit 2014 nga NH "IberLepenc" sh. a. Prishtinë, janë:

- për KRU "Prishtinën" sh. a. Prishtinë është 0.0455 €/m3, dhe

- për KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë është 0.0184 €/m<sup>3</sup>.

Tarifat volumetrike të shërbimeve të furnizimit me ujë për pesë (5) kompani regionale të shërbimeve të ujit për vitin 2014 kanë mbete të njëjta – si tarifat e vitit 2013, ndërsa për nga një (1) euro cent për metër kub, ose 0.01 €/m<sup>3</sup> janë ngrit tarifat e shërbimit të ujit për konsumatorët shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë të shërbyer me shërbimet e ujit të zonave të shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor” sh. a. Prizren dhe KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë.

Mbi tarifat e përcaktuara për vitin 2014 kompanitë e shërbimeve publike janë të obliguara të kalkulojnë edhe TVSH-në e aplikueshme në vend.

Tarifat e vitit 2014 vlejné nga 1 janari 2014 gjer me 31 dhjetor 2014.

Përmes tabelës Nr.5. mund të bëjmë krahasimin e tarifave me shtetet e rajonit. Për krahasim janë marrë qytetet nga vendet e rajonit të cilat hyjnë në grupin e qyteteve të cilat për afërsisht kanë numrin e njëjtë të konsumatorëve me kompanitë të cilat operojné në Kosovë.

Tabela Nr. 5. Krahasimi i tarifave me Shtetet e Rajonit

Nr	Shteti	Kompania - Qyteti	Konsumatorët	Tarifa per uje dhe kanalizim €/m <sup>3</sup>
1	Kosove	Mesatarja e Sektorit	Shtëpiak	0.41
			Jo-Shtëpiak	0.86
2	Shqiperi	Mesatarja e sektorit	Klientë familjar	0.50
			Ente privat	1.25
3	Maqedoni	Shkup	Konsum. fizik	0.47
			Konsum. juridik	1.06
4	Mali i Zi	Herceg Novi	Konsum. shtëpiak	1.05
			Konsum. afarist	2.16
5	Serbi	Novi Sad	Klientë individual	0.67
			Klientë afarist	1.58
6	Bosnja dhe Hercegovina	Sarajevë	Konsum. fizik	0.51
			Konsum. juridik	1.33
7	Kroacia	Osijek	Konsum. fizik	1.37
			Konsum. juridik	1.95

Shenim:

Kursi valutor është marr nga Banka Qendrore e Kosovës i datës 11.03.2013

Siç shihet edhe në tabelën nr.5. lartësia e tarifave në Kosovë është në nivel të mesatares së regjionit.

### 3.2.3. MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SEKTORIT DHE OFRUESËVE TË SHËRBIMIT

Në këtë kapitull, përmes disa prej Treguesve Kyç të Performancës (TKP) është paraqitur performanca e përgjithshme e sektorit në përgjithësi si dhe performanca individuale e KRU-ve për periudhën raportuese 2012/2013.

Më qëllim të paraqitjes së trendeve të zhvillimit të disa prej treguesve kyç të sektorit në përgjithësi është paraqitur edhe analiza për periudhën 5 vjeçare.


Përmes diagrameve dhe informatave në vijim përveç prezantimit të performancës krahasuese mes vitit 2012 dhe 2013 (të sektorit në përgjithësi dhe performancës individuale të KRU-ve) është paraqitur edhe krahasimin i performancës mes shtatë KRU-ve qe ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.



### 3.2.3.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në nivel të sektorit

Mbulueshmëria me shërbime, nënkupton shkallën e mbulimit të popullatës me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit të sektorit në përgjithësi nga 7- KRU.

Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza (%)



Diagrami Nr.1. Mbulueshmëria me shërbime në nivel të sektorit

Gjatë vitit 2013 shtrirja e shërbimeve me ujësjellës në nivel të sektorit arrin vlerën prej 80% që në krahasim me vitin 2012 ka shënuar progres për 2%, ndërsa sa i përket shtrirjes me shërbimet e ujërave të zeza gjatë vitit 2013 po ashtu kemi progres në nivel sektori për 5% krahasuar me vitin 2012.


Shikuar në periudhën 5 vjeçare (2009 – 2013) mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit ka shënuar progres për 15% ndërsa mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit ka shënuar progres për 11%.

Edhe pse kemi progres të vazhdueshëm, mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit ende nuk është në nivel të kënaqshëm, prandaj përmes planifikimit dhe përfshirjes së investimeve në zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime, kompanitë duhet të angazhohen gjatë viteve në vazhdim me qëllim të përmbushjes së objektivave afatgjate të mbulueshmërisë së plotë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### 3.2.3.2. Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit në nivel të kompanive

Në vijim është paraqitur performanca individuale e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë për shtatë KRU-të.

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujësjellës



Diagrami Nr.2. përqindja (%) e popullësisë në zonën e shërbimit me furnizim me ujë


Gjatë vitit 2013 shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit e ka KRU ,Radoniqi' me 99% e cila krahasuar me vitin 2012 ka progres për 3%. Po ashtu edhe KRU ,Prishtina' ka shënuar progres për 6% më shumë mbulueshmëri, gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012.

Shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit gjatë vitit 2013 e ka shënuar KRU 'Hidromorava' me 61% edhe pse në raport me vitin 2012 ka shënuar rritje për 4%.

Të gjitha kompanitë kanë shënuar progres gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012 në përjashtim të KRU 'Hidrodrinit' e cila ka rënie në këtë tregues për 2% dhe kjo ndodhë për arsye të marrjes nën menaxhim të Nj. Operative të Deçanit që nga Shtatori i vitit 2013.

### 3.2.3.3. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit në nivel të kompanive

Në vijim është paraqitur performanca individuale e mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit për shtatë KRU-të.




Diagrami Nr.3. përqindja (%) e mbulueshmëria së popullatës me shërbimet e kanalizimit

Shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit gjatë vitit 2013 e ka arritur KRU ,Prishtina' me 79%, krahasuar me vitin paraprak 2012 sa ishte 71%, ndërsa në shkallën më të ulët është KRU ,Hidrodrini' me 42% mbulueshmëri të shërbimeve të kanalizimit.

Të gjitha kompanitë në përgjithësi kanë shënuar progres në këtë tregues duke rritur kështu mbulueshmërinë me shërbime të kanalizimit gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin paraprak 2012.

### 3.2.3.4. Uji i prodhuar, shitjet dhe uji i pafaturuar në nivel të sektorit




Diagrami Nr.4. Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Gjatë vitit 2013, nga shtatë KRU janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët mbi 134 milion m<sup>3</sup> ujë të pijshëm.

Është shënuar rënie e prodhimit të ujit gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Arsyeja e kësaj rënie është zvogëlimi i prodhimit të shumica e kompanive (përveç KRU “Hidrodrini” dhe KRU “Hidromorava” që kanë pasur rritje të prodhimit në krahasim me vitin 2012)

Faturimi i ujit gjatë vitit 2013 është afro 58 milion m<sup>3</sup> ndërsa UPF është në nivelin prej 77 milion m<sup>3</sup>.

### 3.2.3.5. Efiçenca e faturimit dhe arkëtimit në nivel të sektorit



Diagrami Nr. 5. Qarkullimi dhe arkëtimi

Efiçenca e Qarkullimit<sup>1</sup> në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2013, ka shënuar përmirësim për 1,662,668.77 € apo shprehur në përqindje për 6% në raport me vitin 2012.

Efiçenca e arkëtimit<sup>2</sup>, në vitin 2013 po ashtu ka shënuar përmirësim në vlerë monetare për 1,309,351.27€, apo shprehur në përqindje për 6% në krahasim me vitin 2012.


### 3.2.3.6. Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit paraqet raportin mes arkëtimit dhe faturimit për shërbimet e ofruara

Në vijim është paraqitur performanca individuale e kompanive për këtë tregues për vitin 2013 krahasuar me 2012

<sup>1</sup> Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative,

<sup>2</sup> Keshi ( Efiçenca e arkëtimit) ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative.



Diagrami Nr.6. Shkalla e arkëtimit

Në vitin 2013, shkalla e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe kanalizimit si mesatare e sektorit është 70% dhe mbetet e njëjtë me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2013 progresin me të mirë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU “Hidrodrini” me një ngritje prej 4% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa performancën më të ultë në shkallën e arkëtimit e ka KRU ‘Mitrovica’ me vetëm 50%.

Kompanitë të cilat kanë pasur ngritje të shkallës së arkëtimit në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak janë KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ me 2%, dhe KRU “Bifurkacioni” 1%. KRU “Radoniqi” dhe KRU “Hidromorava” kanë shënuar trende negative në këtë tregues prej 3% përkatësisht 4%, përdërisa në nivel të njëjtë krahasuar me vitin 2012 kanë mbetur KRU “Prishtina” me 75% dhe KRU “Mitrovica” me 50%.


Caku i Planifikuar për 2013 në nivel të sektorit ka qenë 75% që do të thotë se shkalla aktuale e arkëtimit prej 70% në nivel të sektorit paraqet mospërbushje prej 5% në raport me planifikimin.

### 3.2.3.7. Uji i Pafaturuar

Uji i pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet) – ndryshe i quajtur si “ujë i humbur” apo “humbje”.

UPF paraqet humbjet teknike (rrjedhjet) dhe humbjet komerciale (kyçjet ilegale, pasaktësitë gjate leximit në ujëmatës, faturimit pa ujëmatës, etj).

Niveli i lartë i UPF, ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit.



Diagrami Nr.7. Uji i pa-faturuar

Shprehur në përqindje Uji i Pafaturuar në nivel të sektorit gjatë vitit 2013 është 57% përderisa në 2012 ka qenë 58%<sup>3</sup>,

Gjatë vitit 2013 shumica e KRU kanë shënuar progres sa i përket këtij treguesi, në përjashtim të KRU 'Hidrodrini' e cila ka shënuar rritje të humbjeve nga 66% sa ishte në vitin 2012 në vitin 2013 (si rezultat i rritjes së prodhimit të ujit në raport me vitin 2012, ndërsa faturimi pothuajse ka mbet i njëjtë).

Përmirësim të dukshëm në vitin 2013 në raport me vitin 2012 kanë shënuar KRU "Radoniqi" me 7% të zvogëlimit të humbjeve dhe KRU "Hidromorava" me 6% të zvogëlimit të humbjeve. Zvogëlimi i humbjeve të këto dy KRU është rezultat i rritjes së faturimit gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012.


Zvogëlimi i humbjeve të ujit është një sfidë e vazhdueshme jo vetëm për Kosovën por edhe për vendet e rajonit. Përmes tabelës së mëposhtme (tabela Nr.6.) mund të bëhet krahasimi i këtij treguesi me vendet e rajonit (burimi i të dhënave për vendet e rajonit është IBNET)

Tabela Nr. 6. Krahasimi i UPF (humbjeve të ujit) me shtetet e Rajonit

Nr	Shteti	Viti	% e humbjeve të ujit
1	Kosova	2013	57%
2	Shqipëria	2012	68%
3	Maqedonia	2012	64%
4	Serbia	2013	46%
5	Mali i zi	2012	74%
6	Bosnja dhe Hercegovina	2007	60%

### 3.2.3.8. Kualiteti i ujit

Kualiteti i ujit të pijes është njeri prej standardeve më të rëndësishme për shkak të ndikimit të drejtpërdrejt në shëndetin e konsumatorëve. Niveli i pajtueshmërisë nënkupton numrin e mostrave të cilat përmbushin standardin e cilësisë së ujit në raport me numrin total të mostrave. Pajtueshmëri e ulët do të thotë mangësi në përputhje me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm.



Diagrami Nr.8. Kualiteti i ujit të pijës

<sup>3</sup> Vlera 58% e ujit të pafaturuar ka marrë për bazë edhe sasinë e ujit të faturuar nga KRU "Mitrovica" për Pjesën Veriore.

Gjatë vitit 2013 kompania e cila është ranguar më së miri sa i përket kalueshmërisë së testeve bakteriologjike është KRU 'Radoniq' me 99.8%, ndërsa sa i përket kalueshmërisë së testeve fiziko-kimike kompania e cila është ranguar më së miri gjatë vitit 2013 është KRU 'Prishtina' me 100% kalueshmëri.


Rritja e dështimit të testeve bakteriologjike të vitit 2013 në raport me vitin 2012 është shënuar te KRU "Hidrodrini", 'Bifurkacioni' dhe KRU "Hidromorava", ndërsa rritja e dështimit të testeve fiziko-kimike të vitit 2013 në raport me vitin 2012 është shënuar te KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Mitrovica'

Edhe pse është shënuar progres gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012 akoma vazhdon dështimi i i testeve në aspektin kimik tek KRU 'Hidrodrini' (Klinë), me prezencën e manganit (Mg) dhe të Nitriteve (NO<sub>2</sub>) me vlera shumë më të larta se sa ato të parapara me standardet vendore.

### 3.2.3.9. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës, paraqet numrin e konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve aktiv të shërbyer.

Përveç faturimit real sipas konsumit matja e ujit të shfrytëzuar është një mjet i rëndësishëm për kontrollin e UPF.



Diagrami Nr.9. Proporcioni konsumatorëve me ujëmatës

Në nivel sektori ky tregues ka shënuar përmirësim nga 91% sa ishte në vitin 2012 në 92% gjatë vitit 2013.

Siç shihet edhe nga diagrami nr: 9. Përqindjen me te larte te konsumatoreve te pajisur me ujëmatës e kanë KRU "Prishtina" me 98% dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" me 96%.

Nëse bëjmë krahasim me vendet e rajonit sa i përket këtij treguesi, Kosova me 92% te matjes se ujit kualifikohet nder vendet me përqindje te madhe te pajisjes se konsumatoreve me ujëmatës. Për ilustrim po e paraqesim nivelin e matjes se ujit për disa nga vendet fqinje: [Shqipëria](#) - 58.5%, [Mali i zi](#)- 91%, [Kroacia](#) – 82%, dhe [Maqedonia](#) – 96%.

*(Shënim: Te dhënat për Shqipëri janë shënime nga ERRU për vitin 2013, ndërsa te dhënat për vendet tjera janë shënime te mara nga IBNET për vitin 2012).*

### 3.2.3.10. Performanca e NHE 'Iber Lepenci'

ZRRUK është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci' e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj.O 'Drenas'. Në vazhdim janë dhënë disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2013 në raport me vitin 2012.

Tabela Nr.7. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2012 / 2013	2012	2013
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	17,866,656	17,817,840
Faturimi për ujiin me shumicë (€)	384,449	383,399
Arkëtimi për ujiin me shumicë (€)	365,189	100,934
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	318,700	358,495
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	22	27

Në tabelën Nr.8. është dhënë një pasqyrë të treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Iber lepenci' gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012.

Tabela Nr.8. Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2012	2013
Shkalla e arkëtimit	95%	26%
Norma e punës	1.21	1.07
Norma e mbulimit të punës	1.15	0.28
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.018	0.020

Shkalla e arkëtimit në vitin 2013 ka rënë në 26% në raport me vitin 2012 sa ishte 95%. Kjo rënie është rezultat i mos arkëtimit të borxheve nga KRU 'Mitrovica' nga muaji Gusht 2012 e deri në Dhjetor të vitit 2013 si dhe mungesa e pagesës për muajin Dhjetor 2013 nga KRU "Prishtina".

Siç vërehet edhe nga tabela të gjithë treguesit e marrë për vlerësim kanë treguar performancë më të dobët gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012.

## 3.3. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

### 3.3.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Edhe gjatë vitit 2013 vëmendje dhe fokus të veçantë ZRRUK i ka kushtuar zbatimit të standardeve të shërbimit.

Përmes aktiviteteve të inspektimit, monitorimit, analizave etj, është përcjellë përmbushja e disa prej standardeve të shërbimit siç janë: mënyra e faturimit me theks të veçantë në ndërtesat kolektive, zbatimi i vendimit për faturim paushall, inspektimi i zbatimit të orarit të kufizuar të shërbimeve të ujit, formatit të faturave, kushtet e qendrave të konsumatorëve dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve, etj.

Në vazhdim të këtij kapitulli janë të paraqitur më detalisht disa prej standardeve të shërbimit të cilat janë përcjellë gjatë vitit 2013, veprimet e ndërmarra nga ZRRUK dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve

### 3.3.1.1. Faturimi në ndërtesat kolektive

Aktiviteti i inspektimit është ndërmarrë me qëllim të kontrollimit të mënyrës së faturimit të konsumatorëve të cilët gjenden në ndërtesat e banimit kolektiv (banesa). Gjatë këtij inspektimi janë kontrolluar :

- ***Rregullshmëria e leximit të ujëmatësve të përbashkët***

Leximi i ujëmatësve ka rezultuar në përgjithësi i kënaqshëm, mirëpo për të ngritur edhe më tej këtë standard (si dhe me qëllim të leximit sa më të rregullt të ujëmatësve ) i cili sipas Rregullës për Standardet Minimale të Shërbimit të Ofruesve të Shërbimit të Ujit në Kosovë (R-03/U&K) - leximi i ujëmatësit duhet bërë së paku çdo 3 muaj, ZRRUK ka marrë Vendim për korrigjimin e këtij standardi të shërbimit në mënyrë që leximi i ujëmatësve të bëhet çdo muaj – Vendim i cili ka hy në fuqi nga data 26.04.2013

- ***Mënyra e faturimit te ndërtesat të cilat faturohen përmes ujëmatësit të përbashkët***

Sipas R-03/U&K për shpërndarjen e ngarkesës së lexuar në ujëmatësin e përbashkët gjatë faturimit të konsumatorëve në ndërtesat kolektive valide është lista e banorëve e cila procedohet nga përfaqësuesi i ndërtesës kolektive– listë e cila duhet të jetë e nënshkruar nga të gjithë konsumatorët.

Gjatë inspektimit është vërejtur se për shkak të mosfunksionimit të këshillave banesor në shumicën e rasteve këto lista nuk përpilohen nga banorët dhe faturimi bëhet përmes shpërndarjes së njëtrajtshme për njësi banesore (secili konsumator ngarkohet me sasi të njëjtë) të ngarkesës së ujëmatësit të përbashkët. Pothuajse të gjitha rastet gjenden në Nj. Operative Prishtinë.

ZRRUK i ka rekomanduar KRU që të bëjë sensibilizimin e konsumatorëve përmes shpalljeve të cilat KRU është obliguar që ti vendosë në ndërtesa. Përmes takimeve me përfaqësuesit e KK Prishtinë, ZRRUK ka arritur që ti sigurojë listat e kryesuesve të këshillave shtëpiak për rreth 100 ndërtesa në Prishtinë.

Me gjithë hapat e ndërmarrë edhe nga ZRRUK edhe nga KRU rezultatet në këtë aspekt akoma nuk janë të kënaqshme.

Për rastet kur ndërtesa nuk ka ujëmatës të përbashkët dhe shumica e konsumatorët faturohen sipas paushallit të aprovuar nga ZRRUK , u është rekomanduar KRU-ve (Hidromorava, Hidrodrini dhe Mitrovica) që deri në vendosjen e ujëmatësve individual të vendosen ujëmatësit e përbashkët me qëllim të eliminimit të faturimit paushall.

Procesi i vendosjes së ujëmatësve të përbashkët për këto KRU është duke u monitoruar nga ZRRUK.

- ***Shpërndarja e ngarkesave te ndërtesat me ujëmatës të përbashkët***

Gjatë verifikimit të shpërndarjes së ngarkesave përmes ujëmatësit të përbashkët për rastet kur në kuadër të ndërtesës ka edhe ujëmatës individual janë evidentuar parregullsi në Nj. O. Prishtinë. Parregullsitë konsistojnë në faktin se sasia e ujit e cila i faturohet konsumatorit me ujëmatës individual nuk është zbritur nga sasia e ujit në ujëmatësin e përbashkët dhe i njëjti ujë është faturuar 2 herë (një herë te konsumatori me ujëmatës individual dhe i njëjti u është shpërndarë edhe konsumatorëve tjerë të cilët faturohet përmes ujëmatësit të përbashkët). Edhe më shqetësuese në këto raste ka qenë sidomos kur në kuadër të ndërtesave ka pasur konsumator komercial (restorante, lokale etj).

ZRRUK ka kërkuar nga KRU “Prishtina” përmirësimin e këtyre rasteve dhe kompensimin e konsumatorëve të dëmtuar.



Sipas rekomandimeve të ZRRUK, KRU "Prishtina" ka filluar përmirësimin e kësaj dukurie. Nga muaji Qershori deri në Dhjetor 2013 janë kontrolluar lagjet "Ulpiana" dhe "Bregu i Diellit" me ç'rast janë përmirësuar gabimet në 41 ndërtesa dhe gjithsej janë kompensuar 770 konsumatorë në vlerën prej 6700 euro gjithsej.

Ky proces i përmirësimit dhe kompensimit është në vazhdim nga KRU "Prishtina" dhe është duke u monitoruar nga ZRRUK.

### 3.3.1.2. Vazhdimi i zbatimit të Vendimit për Paushall

Përpjekjet e ZRRUK për eliminimin e faturimit paushall kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Ka përmirësim në këtë aspekt, megjithatë eliminimi komplet i faturimit paushall nuk ka arritur të realizohet.

Pas inspektimit është vërejtur se aplikimi i paushallit sipas Procedurave të aprovuara nga ZRRUK ka ndikuar pozitivisht tek konsumatorët për vendosjen e ujëmatësve individual.

Duke parë efektet pozitive të këtij Vendimi ZRRUK ka vendosur vazhdimin e Vendimit për faturim Paushall sipas Procedurave interne të aprovuara nga ZRRUK.

Ky proces do të vazhdojë të monitorohet nga ZRRUK deri në eliminimin e përgjithshëm të faturimit paushall

Për ti dhënë lexuesit të këtij Raporti një pasqyrë më të qartë të ndarjes së kategorive të konsumatorëve të cilët faturohen paushall në vijim po ju paraqesim "**Udhëzuesin për përcaktimin e faturimit të konsumatorëve pa ujëmatës**", i cili me qëllim si të mbrojtjes së konsumatorëve ashtu edhe për lehtësimin e punës së Kompanive me aprovimin e ZRRUK aplikohet nga 01 shtator 2012.

#### a. Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës të cilët ende pritet të instalojnë ujëmatësin.

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit duhet të kategorizojnë konsumatorët shtëpiak sipas llojit të shtëpisë në bazë të tri kategorive në vijim:

- ✓ Apartamente
- ✓ Shtëpi me kopsht të vogël ose pa të (shtëpi urbane), dhe
- ✓ Shtëpi të mëdha me kopshte të mëdha (rurale/ gjysmë-rurale).

Konsumatori shtëpiak pa ujëmatës duhet të definohet në bazë të njërës nga tre kategoritë të cekura më lart. Analiza për të përcaktuar vëllimin e konsumit mujor për qëllime të ngarkimit duhet të jetë 1.5 x ngarkimi mesatar të matur për atë kategori.

#### b. Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës në rastet kur ujëmatësi është jofunksional (kur ujëmatësi nuk është dëmtuar qëllimisht nga konsumatori). Deri në kohën që ujëmatësi riparohet ose ndërrohet, për këto raste bazë për vlerësimin e konsumit merret sasia e shpenzuar e ujit (konsumi) sipas historikut të shpenzimeve për atë konsumator.

#### c. Konsumatorët shtëpiak në rastet kur ujëmatësi është hequr / dëmtuar nga konsumatori.

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit duhet të vendosin një ngarkesë (dënim) më të lartë të konsumit të ujit në të dyja rastet:

- ✓ 3 x volumin e konsumit para dëmtimit në rastet kur të dhënat e konsumit të ujit të mëparshëm ekzistojnë, ose
- ✓ 3 x konsumin mesatar për llojin e shtëpisë sikurse është përcaktuar më lartë, në kategorinë e konsumatorëve 1.

#### a) Konsumatorët jo-shtëpiak (pa marrë parasysh rrethanat se pse ata nuk kanë ujëmatës). Për këtë kategori të konsumatorëve faturimi paushall bëhet në këtë mënyrë:

Kur të dhënat për konsumin e kaluar ekzistojnë, konsumimi historik për këta konsumator duhet të jetë bazë për vlerësimin e konsumit pa ujëmatës deri në kohën që ujëmatësi

riparohet ose ndërrohet, përveç nëse Ofruesit e Shërbimeve të Ujit kanë dëshmi të forta që sugjerojnë se konsumi është më i lartë se ai i regjistruar më herët.

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit duhet të vendosin vlerësim (dënim) të lartë të konsumit të ujit në të dy rastet:

- ✓ 3 x volumin para dëmtimit në rastet kur të dhënat e konsumit të mëparshëm ekzistojnë, ose
- ✓ 3 x volumin e konsumit mesatar të ujit për llojin e njëjtë apo të ngjashëm të Konsumatorit.

### 3.3.1.3. Faturat

Është ndërmarrë aktivitet i inspektimit mbi formatin dhe përmbajtjen e faturave, si dhe formatin dhe përmbajtjen e dokumenteve të tjera të cilat KRU-të i aplikojnë me konsumatorët (formatet e paralajmërimeve për shkyçje, procesverbalet e shkyçjeve, rikyçjeve etj).

Me qëllim të transparencës dhe qartësisë më të madhe në raport me konsumatorin ZRRUK është në procesin konsultimeve dhe rekomandimeve për secilën KRU veç e veç për përmirësimet e duhura konform Rregullës mbi Kartën e Konsumatorëve për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

### 3.3.1.4. Regjimi I kufizuar I shërbimeve të ujit

Meqenëse gjatë sezonës verore disa nga KRU-të për shkak të mungesës së ujit janë të detyruar të aplikojnë regjim të kufizuar të furnizimit me ujë ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të konform rregullës për Standartet Minimale të Shërbimeve planin e reduktimeve dhe plotësimin e të gjitha procedurave të parapara me rastin e aplikimeve të reduktimeve.

Meqenëse problemet më të mëdha të furnizimit të rregullt me ujë i ka pasur KRU "Prishtina" si dhe duke pasur parasysh numrin më të madh të konsumatorëve që e furnizon kjo KRU, gjatë muajit Gusht 2013 është inspektuar zbatimi i orarit të reduktimeve në të gjithë zonën e shërbimit të KRU "Prishtina".

Arsye e këtij inspektimi përveç verifikimit të zbatimit të orarit kanë qenë edhe ankesat e konsumatorëve për diskriminim gjatë furnizimit me ujë (me pretekstin se disa pjesë të qytetit favorizohen e disa janë më pak të furnizuara).

Inspektimi ka përfshi rreth 120 konsumatorë (60 prej tyre në lagjet e ndryshme të qytetit të Prishtinës). Nga ky inspektim mund të themi se KRU "Prishtina" duke pasur parasysh kapacitetin ekzistues të akumulacioneve, kapacitetin e prodhimit të ujit, konfiguracionin e terrenit, humbjet e mëdha të ujit si dhe keqpërdorimet e shumta nga konsumatorët e pandërgjegjshëm, në përgjithësi është mundur të furnizoje me ujë në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë konsumatorët dhe në përgjithësi e ka respektuar orarin e kufizuar të furnizimit me ujë të cilin e ka paraqitur pranë ZRRUK.

### 3.3.2. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve( KKK)

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve konform nenit 17 të Ligjit L-086, si dhe konform Nenit 7 pika 7.1 të Rregullës për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturave në Kosovë (ZRRUM-R-08/U&M), është paraparë Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre Komisioneve.

Në kuadër të ZRRUK, këto komisione janë të themeluara dhe funksionojnë në shtatë Regjionet e Kosovës, ku secila komunë brenda Regjionit të përcaktuar e ka nga 1 (një) përfaqësues në KKK.

Anëtarët e këtyre komisioneve janë zgjedhur sipas propozimeve nga Kryetarët e Komunave (pas intervistave dhe konsultimeve).

Në KKK janë të përfaqësuar të gjitha komunat të cilat i janë nënshtruar procesit të konsolidimit dhe të rajonalizimit, përfshirë edhe komunat të cilat me vendime të një anshme janë larguar nga Kompanitë Rajonale.

### 3.3.2.1. Aktivitetet e KKK

- Gjatë vitit 2013 janë mbajtur 76 takime të rregullta të KKK, takime në të cilat përveç shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve janë shqyrtuar edhe shumë çështje me rëndësi të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në interesin e konsumatorëve siç janë :
  - Shqyrtimi Rregullave të KRU-ve për Procedurat e shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve
  - Informim për lidhjen e Kontratave të Shërbimit
  - Shqyrtimi i Raportit vjetor të KKK
  - Shqyrtimi i Raportit të Performancës
  - Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve, me ç’rast të gjithë anëtarët e KKK janë kyçur në inspektimin dhe raportimin e ndërmarrë nga ZRRUK lidhur me furnizimin me ujë
  - Shqyrtimi i Raportit lidhur me zbatimin e Rregullës për standardet minimale të shërbimit, etj
  - Shqyrtimin e harmonizimit me Ligjin dhe legjislacionin sekondar të ZRRUK të Procedurave të Ofruesit të Shërbimeve për shqyrtimin e ankesave të Konsumatorëve.
- Më kërkesë të ZRRUK gjegjësisht KKK, nga Kompanitë e licencuara të ujësjellësit është bërë vendosja e kutive për ankesa në vende të dukshme në objektet e tyre, ku konsumatorët e pakënaqur me përgjigjen e marrë nga kompania mund ti drejtojnë ankesat në KKK-të për Regjionin përkatës. Vendosja e këtyre kutive përveç në objektet e Kompanive është bërë edhe në Njësitë Operative në gjithë zonën e shërbimit të Kompanive .

### 3.3.2.2 Shqyrtimi i ankesave

Në vijim (tabela Nr.9.) është dhënë në formë tabelore, numri dhe struktura e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të regjionale në vitin 2013.

Tabela Nr.9. Numri i Ankesave të Parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtato	Tetor	Nënto	Dhjeta	Gjiths ei
KKK Prishtinë	5	5	3	7	4	1	2	3	1	3	6	2	42
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	1
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjakovë	-	1	1	-	2	-	-	1	-	-	1	-	6
KKK Prizren	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	3
KKK Ferizaj	-	2	1	1	1	-	-	-	-	1	1	-	7
KKK Gjilan	-	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	3
<b>Gjithsejtë</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>11</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>62</b>

Tabela Nr.10. Numri i Ankesave të zgjedhura nga KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho r	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
KKK Prishtinë	5	4	-	4	1	1	-	-	-	2	4	2	23
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjakovë	-	1	-	2	-	-	-	1	1	-	-	-	5
KKK Prizren	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	2
KKK Ferizaj	1	1	1	2	-	-	-	-	-	1	1	-	7
KKK Gjilan	-	-	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	3
<b>Gjithsejtë</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>40</b>

**Shënim:**

7 - Ankesa iu janë kthyer palëve për plotësim lënde.

15 - Ankesa në bashkëveprim me Kompanitë dhe konsumatorët janë zgjedhur.

Bazuar në analizimin më të hollësishëm të ankesave, është bërë ndarja e ankesave sipas kategorive në vijim:

**a) Shpërndarja e ankesave sipas KKK regjionale:**

Siq shifet edhe nga tabela Nr.9. numri më i madh i ankesave është evidentuar në KKK Prishtinë me 42 ankesa.

**b) Natyra e ankesave:**

- Ankesat lidhur me faturimin paushall – janë 33 ankesa
- Ankesat lidhur me shlyerjen (fshirjen) e borxhit – janë 29 ankesa

**c) Lloji i konsumatorëve:**

- Nga të gjitha ankesat e marra, 58 ankesa janë nga konsumatorët shtëpiak
- Nga të gjitha ankesat e marra 4 ankesa janë nga konsumatorët joshtëpiak

## 4. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

### 4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV

Në këtë kapitull janë paraqitur aktivitetet në fushën e legjislavit të cilat ZRRUK i ka ndërmarrë gjatë vitit 2013 në pajtim me Planin Strategjik 2012-2014 të ZRRUK dhe në bazë të obligimeve dhe kompetencave që ZRRUK i ka.

#### 4.1.1. Amandamenti i Ligjit Nr.03/ L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave (“Ligji Nr. 03/L-086”)

Gjatë vitit 2013 ZRRUK i është përgjigjur të gjitha kërkesave të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor (KBMPH) të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të mbështetur përpilimin e draftit të Projekt Ligjit (përmes sugjerimeve, amendamenteve dhe propozimeve të arsyetuara profesionalisht dhe praktikisht)

Projekt Ligj ka kaluar në komisionin e lartpërmendur dhe është në procedurë të mëtejme në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

#### 4.1.2. Shqyrtimi i Rregullës për Standardet Minimale të Shërbimit të Ofruesve të Shërbimit të Ujit në Kosovë (“R03/U&K”)

Gjatë vitit 2013 është bërë ndryshimi i standardit të shërbimit –“Leximi i ujëmatësit” Ndryshimi qëndron në obligimin e kompanive për leximin e ujëmatësve cdo muaj nga cdo 3 muaj sa ka qenë më parë. Për këtë qëllim është nxjerr Vendimi më 26.03.2013 për korrigjimin e standardit të shërbimit leximi i ujëmatësit në baza mujore, i cili u është përcjellë të gjitha Kompanive.

#### 4.1.3. Amandamenti i Licencave të shërbimit

Gjatë vitit 2013 ZRRUK është amendamentuar Licenca e Shërbimit për KRU “Hidrodrini” Sh.A. Pejë. Amandamentim është paraqitur i nevojshëm me rastin e integritit të Komunës së Deçanit në kuadër të zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini”, integrim për të cilin ZRRUK ka dhënë kontributin e vet në bazë të autoritetit që ka me Ligj.

Integrimi i Komunës së Deçanit në kuadër të zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” ka filluar nga data 31 Tetor 2013.

#### 4.1.4. Plotësimi i Kushteve të Licencës së Shërbimit

Me rastin e Licencimit (me 01.11.2012) Kompanitë janë licencuar me obligim për të plotësuar kushtet në vijim:

- **Sigurimin e Lejeve për nxjerrjen e ujit dhe lejet për shkarkimin e ujërave të ndotura** - nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Plotësimin e këtij kushti janë të obliguar ta sigurojnë të gjitha Kompanitë përveç KRU “Mitrovica” e cila është e liruar nga sigurimi i lejes për nxjerrjen e ujit (për arsye se ujin e blen nga NH “Ibër Lepeci”) dhe NH “Ibër-Lepenc” është i liruar nga kushti për shkarkimin e ujërave të ndotura (për arsye se është e licencuar vetëm për furnizim të ujit të papërpunuar me shumicë).

- **Lidhjen e Marrëveshjeve të Shërbimit** - me Komunat. Plotësimet të këtij kushti i janë nënshtruar të gjitha kompanitë, përveç KRU "Hidroregjioni Jugor" dhe KRU "Radoniqi" të cilët e kanë nënshkruar Marrëveshjen me Komunat përkatëse.
- **Qëndrueshmëria financiare e KRU-ve** - plotësimet të këtij kushti i janë nënshtruar të gjitha Kompanitë e licencuara.

Me qëllim të plotësimit të kushteve të lartpërmendura ZRRUK gjatë vitit 2013 është angazhuar duke shfrytëzuar autoritetin e vet përmes organizimit të takimeve me të gjitha palët përgjegjëse - me Kompanitë, me MMPH (për nxjerrjen e lejeve) dhe MZHE (për inkorporimin e Komunave të sapoformuara dhe atyre që janë përfshirë në procesin e Regjionalizimit) me SHUKOS etj.

Si rrjedhojë e këtyre aktiviteteve kemi këto rezultate:

- Janë siguruar Vendimet për nxjerrjen e ujit
- Nuk është arritur sigurimi i nxjerrjes së lejeve për shkarkimin e ujërave të ndotura (për arsye se MMPH se ende nuk ka arritur të rregullojë infrastrukturën formale, teknike dhe legjislative për këtë aktivitet)
- Është arritur të zyrtarizohet Marrëveshja e Shërbimit me Komunën e Graçanicës dhe Deçanit. Komunat tjera refuzojnë Marrëveshjen duke u arsyetuar me kompetencat që kanë me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale.
- Qëndrueshmëria financiare – ky aktivitet do të zhvillohet pas përfundimit të viti kalendarik i cili ndërlidhet me afatin e dhënë në licencën e shërbimit, si dhe me përfundimin e vitit fiskal të raportimit.

#### 4.1.5. Paralajmërimet

Me qëllim të zbatimit të kuadrit Ligjor, gjatë vitit 2013, ZRRUK bazuar në kompetencat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit nr. 03/L-086 ka proceduar tri paralajmërimet për Ofruesit e Shërbimeve të ujit dhe kanalizimit të cilët operojnë pa Licenca të shërbimit.

Në tabelën e mëposhtme (tabela Nr.11.) janë paraqitur Ofruesit e Shërbimeve të Paralajmëruar në 2013

Tabela Nr.11. Paralajmërimet për mosposedim të licencës së shërbimit

Nr.rend.	Ofruesi i Shërbimit	Nr. i Paralajmërimet	Baza e Paralajmërimet	Vërejtje
01	NPK "Lypoteni"-Kaçanik	566	Mos posedim të lic. së shërb.	Është përgjigjur
02	NPK "Štrpce" -Shtërpce	568	Mos posedim të lic. së shërb.	Kanë refuzuar pranimin
03	NPK "Vodovod Ibar"- Mitrovica e Veriut	569	Mos posedim të lic. së shërb.	Kanë refuzuar pranimin

Në këto paralajmërimet është përgjigjur vetëm NPK "Lypoteni" – Kaçanik përderisa NPK "Štrpce" – Shtërpce dhe NPK "Vodovod Ibar"- Mitrovica e Veriut kanë refuzuar pranimin e paralajmërimet.

Duke respektuar procedurën e mëtejme ZRRUK ka nxjerr Vendim për gjobitje për këto 3 Kompani - për secilën Kompani nga 20.000 €. Këtë Vendimin e kanë apeluar NPK "Lypoteni" – Kacanik dhe NPK "Štrpce" –Shtërpce.

Procedurat e mëtejme janë duke vazhduar në vitin 2014.

#### 4.1.6. Procedurat Gjyqësore

Aktiviteti i filluar në vitin 2012, me ç'rast janë inicuar Procedura Gjyqësore ndaj Ofruesve të shërbimit për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave për mospërbushje të obligimeve të parapara ndaj ZRRUK (mos pagesën e taksës vjetore të licencimit) ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013.

Nga tetë Propozimet për Përmbarrim të inicuar nga ZRRUK pranë Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, gjatë vitit 2013 janë hapur Procedura Gjyqësore për gjashtë prej tyre (për KMDK Prishtinë, KRM "Pastërtia"-Ferizaj, KRM "Cabрати"-Gjakovë, KRM "Ambienti"-Pejë, KRM "Uniteti"-Mitrovicë, KRM "Pastrimi"-Prishtinë), ndërsa për KRM "Higjiena" –Gjilan dhe KRM "Ekoregjioni"-Prizren ende nuk janë inicuar Procedurat Gjyqësore nga Gjykata.

Nga gjashtë rastet e Procedura Gjyqësore, me KMDK (Prishtinë) është arritur marrëveshje për programim të borxhit – marrëveshje e cila deri tani është duke u respektuar.

Rastet tjera janë duke u zhvilluar sipas punës së gjykatës.

#### 4.1.7. Shqyrtimi i Kërkesave për Shkyçje Kolektive

Në pajtim me Ligjin, rregullat dhe procedurat e brendshme, ndër detyrat tjera ZRRUK ka obligim edhe shqyrtimin e kërkesave për shkyçje kolektive të cilat parashtrohen nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit.

Gjatë vitit 2013 pranë ZRRUK janë parashtruar gjithsej 19 kërkesa (aplikacione) për shkyçje kolektive.

Në tabelën e mëposhtme (tabela Nr.12.) janë paraqitur rastet e shqyrtuara të kërkesave për shkyçje kolektive gjatë vitit 2013 .

Tabela Nr.12. Aplikacionet e shqyrtuara për shkyçje

Nr. rend	KRU	Aplikacioni	Aprovuar- Nuk është aprovuar
1	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	2069	Aprovuar
2	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	2239	Nuk është Aprovuar
3	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	142	Aprovuar
4	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	234	Aprovuar
5	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	259	Nuk është Aprovuar
6	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	257	Nuk është Aprovuar
7	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	262	Nuk është Aprovuar
8	"Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	957	Nuk është Aprovuar
9	"Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren	1205	Nuk është Aprovuar
10	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	477/3	Nuk është Aprovuar
11	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	478/3	Nuk është Aprovuar
12	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	479/3	Nuk është Aprovuar
13	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	480/3	Nuk është Aprovuar
14	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	481/3	Nuk është Aprovuar
15	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	482/3	Nuk është Aprovuar
16	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	483/3	Nuk është Aprovuar
17	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	484/3	Nuk është Aprovuar
18	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	485/3	Nuk është Aprovuar
19	"Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë	486/3	Nuk është Aprovuar

Nga 19 rastet e shqyrtuar janë aprovuar 3 raste, ndërsa 16 raste nuk janë aprovuar.

Aplikimi i shkyçjeve kolektive të aprovuara nga ZRRUK është monitoruar në vazhdimësi, në mënyrë që KRU ti plotësojë të gjitha hapat dhe procedurat e parapara me rastin e shkyçjeve kolektive.

## 5. Relacionet e Jashtme

### 5.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA

Bashkëpunimi i hapur i ZRRUK me të gjitha palët e interesit (si Kosovare ashtu edhe Ndërkombëtare) përmes koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informatave, përvojave etj, me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive në sektorin e ujit ka qenë aktivitet i vazhdueshëm edhe gjatë vitit 2013.

#### (i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, edhe gjatë këtij viti ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin në fushën e monitorimit të përmbushjes së parametrave të cilët përcaktojnë standardet e kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

#### (ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë, ZRRUK edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH.

ZRRUK ka pasur disa takime me përfaqësuesit e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave, e posaçërisht rreth lejeve ujore.

#### (iii) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MZHE

ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrje publike qendrore.

Gjatë vitit 2013, kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta dhe punëtori me qëllim të zhvillimit të sektorit

#### (iv) Bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropiane

Raportimet e rregullta për Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), si dhe raportimi për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asocimit (DPSA) është përmbushur nga ZRRUK sipas kërkesave të MIE. Janë mbajtur takime lidhur me analizimin e sfidave të dala nga Raporti i Progresit, si dhe koordinimi me MIE për zbatimin dhe paraqitjen e sfidave të dala nga ky Raport për çështjet e sektorit të cilat i përkasin ZRRUK në PVPE 2014.

#### (v) Bashkëpunimi me Palët tjera (Në Kosovë dhe jashtë Vendit)

Në vitin 2013, ZRRUK ka bashkëpunuar edhe me palët tjera të interesit si :

- Vizitë zyrtare të Shoqatës së Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Budapestit të Republikës së Hungarisë, për pjesëmarrje në Samitin Botëror të Ujit të Budapestit (SUB) - Forumi për Biznes.
- Takim me Ministrin e MZHE, rreth implementimit të Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 06/18.
- Bashkëpunimi me Task Forcën e Ujit (TFU) pranë Zyrës së Kryeministrit.



- Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH)
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM).
- Asociacionin e Komunave të Kosovës,
- SHUKOS –Shoqata e Ujesjellësve të Kosovës
- SHUKALB – Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve të Shqipërisë
- Shoqatën e Ujësjellësve të Bullgarisë (BWA)
- Takim me zv.Ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal të Bullgarisë
- Entin Statistikor të Kosovës
- Përfaqësuesit e donatorëve (ZNKE,SDC,USAID, KFW, SCO, GTZ etj. ) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave në Kosovë.
- Bashkëpunimi dhe Raportimi në IBNET, etj

Me të gjitha palët (Kosovare dhe ato jashtë vendit), përmes takimeve të drejtpërdrejta, punëtorive dhe prezantimeve, ZRRUK ka dhënë kontribut duke paraqitur qëndrimin e vet lidhur me arritjet dhe ngecjet e sektorit. Bashkëpunimi me të gjitha palët gjithashtu na ka ndihmuar të informohemi me zhvillimin e sektorit dhe përvojat e vendeve tjera .

## 5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË

Rëndësi të vecantë edhe gjatë këtij viti i është kushtuar bashkëpunimit me Rregullatorët e tjerë të sektorit të ujërave. Ky bashkëpunim është i nevojshëm për shkëmbim të përvojave dhe adaptimin e praktikave më të mira me qëllim të plotësimit të obligimeve tona për rregullimin ekonomik të shërbimeve të ujit. Aktivitetet e ZRRUK në këtë aspekt gjatë vitit 2013 në pika të shkurta janë:

- Bashkëpunimi me rregullatorin ekonomik të shërbimeve të ujit të Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i iniciuar më herët, e që është formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Kemi pasur një vizitë pune, dhe shkëmbim të stafit, gjatë tërë vitit 2013.
- Bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe me shkëmbimin e Raportit Vjetor të Performancës 2013 të Kosovës.
- Inicimi i arritjes për Marrëveshje të Bashkëpunimit me Rregullatorin e Bullgarisë - me ç'rast është mbajtur takim me përfaqësuesit e Rregullatorit të Bullgarisë në Sofje.
- Pjesëmarrja në takimet dhe punëtoritë e organizuara nga Banka Botërore dhe Programi i Ujërave të Danubit (Danube Water Program - DWP) na kanë mundësuar takime dhe bashkëpunim me të gjithë rregullatorët e shteteve që prekin ujërat e Danubit

## 5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

ZRRUK në vitin 2013 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjerë, për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUK.

Përmes pjesëmarrjes në emisione televizive opinioni është informuar për rolin e ZRRUK në përgjithësi me theks të veçantë rolin dhe funksionimin e KKK.

Me qëllim të informimit të konsumatorëve, sensibilizimin e opinionit për rolin e KKK-ve, si dhe për të inkurajuar konsumatorët për pjesëmarrje në takime të KKK, ZRRUK përmes gazetave ditore çdo muaj ka publikuar Orarin e takimeve mujore të KKK në shtyp dhe në web-faqen e ZRRUK.

Përmes mediave dhe shtypit opinioni është njoftuar edhe rreth përcaktimit të tarifave.

ZRRUK përmes ueb faqes [www.wwro-ks.org](http://www.wwro-ks.org) iu ka mundësuar konsumatorëve që të informohen detalisht lidhur me aktivitetet të cilat po i zhvillon ZRRUK .

## 6. Aspektet Financiare

Në këtë pjesë të Raportit është paraqitur një përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve sa i përket aspekteve financiare. Raportimi detal i ZRRUK në aspektin financiar bëhet para Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, si dhe Komisionit për Mbikëqyrje Financiare në Kuvendin e Kosovës.

ZRRUK në vitin fiskal 2013 ka arritur një marrëveshje me Njësinë Harmonizuese të Thesarit lidhur me auditimin e brendshëm si përkrahje për ZRRUK-un i cili ka audituar ZRRUK-un, po ashtu pasqyrat financiare të ZRRUK—ut për vitin 2013 janë audituar edhe nga Auditori i Përgjithshëm ku opinioni i tyre ka qenë shumë pozitiv për ZRRUK-un

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUK janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe Kanalizimit. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kritereve vijuese:

- të hyrat nga këto taksa korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUK për vitin aktual, me kusht që:
- lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.
- Lartësia e Taksës vjetore të Licencimit për vitin 2013 ka qenë 1.32%

Buxheti vjetor i ZRRUK aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e planifikimit të shpenzimeve vjetore ZRRUK udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të mos ketë kosto të lartë për konsumatorët, ku kostoja vjetore e Taksës Vjetore të Licencimit për vitin 2013 për një konsumator ka qenë 3.24 cent apo mujore 0.27cent

### 6.1. SHPENZIMET

Edhe pse ZRRUK të gjitha transaksionet financiare i kryen përmes barazimeve mujore të sistemit të Thesarit, ZRRUK mban kontabilitetin e vet financiar dhe material.

Për vitin fiskal 2013, ZRRUK ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 328,619.00 EUR,

Në tabelën më poshtë (Tabela Nr.13.) është dhënë një pasqyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUK në vitin fiskal 2013 si dhe shpenzimeve të realizuara.

**Tabela Nr.13. Buxheti i ZRRUK për 2013**

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	164,450.00	163,817.87
Mallra dhe shërbime	156,519.00	143,967.50
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	7,650.00	5,438.39
<b>Total Buxheti</b>	<b>328,619.00</b>	<b>313,213.96</b>

**ZRRUK buxhetin e vitit 2013 e ka shpenzuar në 95,.31%**

## 6.2. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2013

ZRRUK për vitin 2013 ka planifikuar të inkasoj 330,544.58 euro nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit, prej të cilave ka inkasuar 315,774.70 euro apo shprehur në përqindje ka inkasuar 95,53% nga të hyrat e planifikuara.

Nga marrëveshja për programim të borxheve me proces gjyqësor me KMDK (Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë) kemi inkasuar 8,041.52€

Nga shqiptimi i dënimeve kemi inkasuar 2,460.00€ (KUR Mitrovica 1,350.00 dhe KUR Hidrodrini 1,110.00€ për mos respektim të standardeve të shërbimit)

Gjithsej ZRRUK ka inkasuar 326,276.22€.

Tabela Nr.14. Të hyrat

Kategoria e Hyrave	Te planifikuara (EUR)	Të inkasuara (EUR)
Te hyrat nga Taksa e Licencimit	330,544.58	315,774.70
Te hyrat nga borgjet e programuara		8,041.52
Te hyrat nga denimet		2,460.00
Te hyrat tjera		
<b>Total Hyrat</b>	<b>330,544.58</b>	<b>326,276.22</b>

Me këtë rast vlen të theksohet që ZRRUK me takse vjetore të licencimit i mbulon të gjitha shpenzimet buxhetore vjetore 100%.

### **Borxhlinjtë e ZRRUK për vitin 2013**

Borxhlinjtë e ZRRUK për vitin 2013 janë të KRU MITROVICA me mos pagese të shtatë(7) kësteve mujore në vlerë prej 15,931.58€.

Në vitin 2012 ZRRUK për inkasimin e borxheve ka iniciuar proces gjyqësor ndaj shtatë Kompanive për Grumbullimin e Mbeturave në Kosovë të licencuara nga ZRRUK. Prej tyre për një kompani KMDK kemi hyre në marrëveshje për programim të borxhit ndërsa për rastet tjera presim vendimet gjyqësore.

Për inkasimin e borxheve të vitit 2013 ZRRUK do të iniciojë procedurat adekuate gjyqësore.

## 6.3. ASETET E ZRRUK

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2013 në ZRRUK është 28,412.00€

## 7. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori si dhe të drejtën e cdo qytetari për të pasur qasje në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, të gjitha Institucionet përgjegjëse në përputhje me përgjegjësitë institucionale dhe ligjore që kanë duhet të angazhohen maksimalisht në avancimin e këtij sektori.

Bazuar në të dhënat, informacionet dhe analizat të cilat gjatë tërë vitit ZRRUK i monitoron, një pjesë e të cilave edhe u prezantuan në këtë Raport, për ngritjen e nivelit të sektorit në përgjithësi dhe në përmirësimin e ofrimeve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në veçanti rekomandojmë:

### ➤ *Në aspektin Legjislativ (Ligjor):*

- Bashkëpunim më të madh mes palëve të interesit të sektorit – Qeverisë, Kuvendeve Komunale, ZRRUK, Donatorëve dhe Kompanive Rajonale të Ujësjellësit
- Qeveria të ndërmerr masat e duhura për Integrimin e Kompanive lokale në kuadër të Kompanive rajonale (në përputhje me Planin e Konsolidimit të ujit dhe Vendimit të Kryeministrit për integrimin e Njësive Operative në kuadër të KRU-ve)
- MMPH të angazhohet në sigurimin sa më të shpejtë të lejeve për nxjerrjen e ujit dhe lejeve për shkarkimin e ujërave të zeza për KRU-të (të cilat janë edhe ndër kushtet e Licencës së kompanive)
- Qeveria së bashku me Kuvendet Komunale dhe KRU-të të angazhohen në integrimi i sistemeve rurale në kuadër të Kompanive Rajonale (sistemet të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të)
- IKSHPK të angazhohet në zbatueshmërinë e Udhëzimit administrativ Nr.16/2012 për përmbushjen e standardeve të kualitetit të ujit të distribuuar nga KRU-të
- Kuvendet Komunale të angazhohen në lidhjen e Marrëveshjeve të Shërbimit me KRU (të cilat janë edhe ndër kushtet e Licencës së kompanive)
- ZRRUK përmes procesit të monitorimit të përmbushjes së standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve të vazhdojë të identifikojë problemet dhe ngecjet në sektor.
- ZRRUK të angazhohet edhe më tej që përmes bashkëpunimit, rekomandimeve, organizimit të punëtorive dhe sugjerimeve të ndihmojë KRU-të në përmbushjen e caqeve të përcaktuara përmes procesit tarifor.

### ➤ *Në aspektin Administrativ:*

- KRU-të të përpilojnë Plane dhe Strategji për:
  - a) Reduktimin e ujit të pa faturuar,
  - b) Menaxhimin e krizave të ujit,
  - c) Ngritjen e nivelit të arkëtimit dhe faturimit,
  - d) Ngritjen e kapaciteteve të ujit – zhvillimin e burimeve të reja,

- e) Rritjen e nivelit të faturimit sipas leximit të ujëmatësve,
- f) Sensibilizimin e opinionit përmes mediave, broshurave, punëtorive nëpër shkolla, etj për kursimin dhe moskeqpërdorimin e ujit.
- Bordet e Drejtorëve të jenë më llogarikërkues ndaj KRU-ve lidhur me përmirësimin e performancës
- Kuvendet Komunale të mbështesin KRU-të përmes inspektoriateve për ndalimin e keqpërdorimeve të ujit
- Kuvendet Komunale të mbështesin Qeverinë lidhur me çështjet pronësore në aspektin e integritit të sistemeve rurale
- ZRRUK të mbështesë KRU-të në zbatimin e të gjitha aktiviteteve të cilat kanë qëllim përmbushjen e Standardeve Minimale të Shërbimit
- ZRRUK të vazhdojë promovimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

➤ **Në aspektin Financiar:**

- Të gjitha palët e interesit në sektor (Qeveria, Kuvendet Komunale, KRU-të, Donatorët, etj) të kenë bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë gjatë planifikimit të mjeteve për investime dhe gjatë caktimit të prioriteteve të investimeve.
- Qeveria, KRU –të dhe Komunitat të ndërmarrin investime të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve të prodhimit të ujit, zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe zhvillimin e burimeve të reja të ujit. Kordinimi mes të gjitha palëve në këtë aspekt është i domosdoshëm.
- Qeveria të sigurojë subvencionimin e faturave për shërbimet e ujit për konsumatorët të cilët janë në gjendje të rendë sociale.

Aprovimi i këtyre rekomandimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe zbatimi i tyre nga të gjitha palët do të ndikojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve me ujë dhe kanalizim.

**Adresa e ZRRUK**

**Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim**

Rruga: Ferat Dragaj, 68  
Prishtinë 10000 Kosovë

**Tel:** +381 (0) 38 249 165

**E-mail:** [info@wwro-ks.org](mailto:info@wwro-ks.org)

**Web:** [wwro.wwro-ks.org](http://wwro.wwro-ks.org)